



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Schoolme Implementation & Consulting” të datës 28.02.2024 si dhe kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Renner” Sh.P.K. kundër njoftimit mbi vendimin të datës 23.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Digjitalizimi i proceseve edukativo – arsimore - ritender” me nr. të prokurimit 616-24-97-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Schoolme Implementation & Consulting” e datës 28.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Digjitalizimi i proceseve edukativo – arsimore - ritender” me nr. të prokurimit 616-24-97-2-1-1.
- II. **MIRATOHET si e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “RENER” Sh.P.K. e datës 28.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Digjitalizimi i proceseve edukativo – arsimore - ritender” me nr. të prokurimit 616-24-97-2-1-1.
- III. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi ndërsa njoftimi mbi vendimin i datës 23.02.2024 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit **ANULOHET**.
- IV. **NJOFTOHET** operatorët ekonomik “Schoolme Implementation & Consulting” si dhe “RENER” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatorët ekonomik "Schoolme Implementation & Consulting" dhe "Rener" Sh.P.K. me datë 28.02.2024 kanë parashtruar kërkesa për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Digjitalizimi i proceseve edukativo - arsimore - ritender" me nr. të prokurimit 616-24-97-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesave për rishqyrtim të parashtruesve është gjetur se kërkesat janë të lejuara dhe janë parashtruar brenda afatit nga personat autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesat e parashtruesve. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesave.

Përmes njoftimit mbi vendimin e datës 23.02.2024, autoriteti kontraktues ka njoftuar se aktiviteti i prokurimit është anuluar për arsye se nuk ka oferta të përgjegjshme për shkak se asnjë nga ofertat e dorëzuara nuk është në përputhje me kurrikulën e re të arsimit në Republikën e Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit "Schoolme Implementation & Consulting" janë se ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme dhe në përputhje të plotë me kurrikulën e re të arsimit në shtetin e Kosovës. Prandaj vendimi i AK për anulimin e aktivitetit është në kundërshtim me nenin 62 të LPP lidhur me nenin 43 të RRPP.

Pretendimet e parashtruesit "RENER" Sh.P.K. janë se në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë nuk është kërkuar që oferta e dorëzuar të jetë në përputhje me kurrikulën e re të arsimit në Republikën e Kosovës. Prandaj vendimi i AK për anulimin e aktivitetit është në kundërshtim me nenin 62 të LPP lidhur me nenin 43 të RRPP.

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të parashtruesve është gjetur se komisioni vlerësues nuk ka arritur që të bëjë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e plotë të tenderëve ashtu që nuk ka arritur që të sqarojë në mënyrë të detajuar arsyet për anulimin e aktivitetit të prokurimit në përputhje me nenin 62 të LPP lidhur me nenin 43 të RRPP.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të parashtruesve. Për këto arsye janë miratuar si të bazuara kërkesat për rishqyrtim të parashtruesve.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.03.2024

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.